



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.602/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri, kryesues, Afijete Sada - Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Hajrush Stublla, nga Lipjani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen e 5 (pesë) anëtarëve të familjes së tij në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Hudhet i parregullt** apeli Anr.602/2021 i paraqitur nga Hajrush Stublla, nga Lipjani, me të cilin kërkon që 5 (pesë) anëtarët e familjes së tij të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 20.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Hajrush Stublla, nga Lipjani, në të cilin pretendon se familja e tij e cila jeton në Francë kanë aplikuar me kohë për të votuar jashtë Kosovës, me datë 12 Gusht 2021 dhe 5 (pesë) anëtarë të familjes së tij nuk janë të përfshirë në listën zgjedhore, ndërsa të njëjtëve nga zyrtaret kompetent të KQZ-së u është thënë se është bërë gabim gjatë shtypjes së listës andaj përmes apelit ka kërkuar nga PZAP që të njëjtin ta shqyrtojë dhe familjarëve të tij tu mundësohet votimi jashtë Kosovës.

PZAP-i me datën 20.09.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje ne apel.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka paraqitur përgjigje në apel me të cilën ka theksuar se lidhur me apelin Anr.602/2021, të datës 20.09.2021, e paraqitur nga Hajrullah Stublla, fjala është për 5 (pesë), anëtarët e familjes Stublla, të cilët kanë aplikuar me kohë për regjistrim, duke i dërguar brenda afatit dokumentet, për të cilat vlerësojmë se është dashur të aprovohen sepse përmbushin kriteret ligjor. Herën e parë kur kanë aplikuar kanë dërguar dokumente të shteteve ku jetojnë e pastaj pasi që u janë kërkuar dokumente shtesë këta aplikues kanë dërguar dokumentet shtesë ashtu siç u janë kërkuar, brenda afatit, por të cilat për arsye teknike dhe gabimet gjatë shtypjes dhe materialeve shtesë këta

edhe janë refuzuar pa të drejtë. Por me datë 2 gushtë 2021, siç shihet në emal (në ëinrar), ne kemi njoftuar për të drejtën ligjore për ankesë duke i njoftuar për arsyet e refuzimit dhe me informatat tjera të hollësishme se ku duhet të drejtohet kjo ankesë.

Paneli, pasi që vlerësoj apelin gjeti se i njëjti është **i parregullt**, për këto arsye:

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i paraqitur, është i parregullt, pasi që apeli i paraqitur në PZAP nga Hajrush Stublla, për familjarët e tij nuk ka të specifikuar saktë emrat e familjarëve se për kë drejtohet apeli, andaj edhe si i tillë ky apel nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.6 dhe 7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *10.6 “Apelet duhet të dorëzohen me shkrim e të jenë të nënshkruar nga ana e parashtruesi i apelit, apo në emër të tij nga personi i autorizuar, në rastet kur parashtruesi i apelit/ankuesi-ja, është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare, ose çfarëdo personi tjetër juridik, apeli duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjor në fuqi”. 10.7 “Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:*

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin*
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt*
- c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimt*
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimt.*

Në rastin konkret parashtruesi i apelit, apelin e ka ushtruar në emër të familjarëve të tij, mirëpo i njëjti nuk ka specifikuar emrat e familjarëve të tij, e gjithashtu nuk ka paraqitur autorizim, për përfaqësim e tyre përmes apelit.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në vlerësimin e meritave të apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur. PZAP, në këtë fazë që gjendet procesi zgjedhor, nuk mund të merr vendim tjetër sepse fillimisht parashtruesi i apelit nuk i plotëson kriteret për të ushtruar apel në PZAP, ashtu siç u vlerësua më lart, e në anën tjetër kanë kaluar mbi 24 orë, nga momenti i publikimit të vendimit të KQZ-së, për certifikimin e listës së votuesve, i cili është afat ligjor për ta ankimuar vendimin e lartcekur, që i bie që ankesa e paraqitur do të ishte edhe e pasafatshme. Mirëpo sipas vlerësimit të PZAP, mbetet në diskrecionin e KQZ-së të vendos, që aplikuesit që në këtë rast i paskan plotësuar kushtet sipas përgjigjes së KQZ në apelin e paraqitur, për tu përfshirë në listën e votuesve si votues jashtë Kosove, a do ti përfshijë të njëjtit apo jo në

listën e votuesve jashtë Kosovës, sepse nuk është arsye që për shkak të gabimeve teknike në shtypje të cilat do të duhej ti përmirësonte vet KQZ, por jo edhe ndonjë organ tjetër, të mbeten të njëjtit jashtë listës së votuesve. Për këto arsye Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 10.6 dhe 7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A.nr. 602/2021, më datën 22.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Zyhdi Haxiri



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.